

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Le Pen nis fushatën për 2027, por tensionet me Bardellan tronditën të djathtën ekstreme franceze                                                                                                                                                                                |
| ADRESA  | <a href="https://kohajone.com/aktualitet/le-pen-nis-fushaten-per-2027-por-tensionet-me-bardellan-tronditin-te-djathten-ekstreme-franceze/">https://kohajone.com/aktualitet/le-pen-nis-fushaten-per-2027-por-tensionet-me-bardellan-tronditin-te-djathten-ekstreme-franceze/</a> |
| BURIMI  | kohajone.com                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                          |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 13 shtator 2026, 18:07:11 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 18:01:51 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 185483d0361bdaff45f0d95a53a5ef199904832170c95e8a92346de5d07811ea |
| TEKSTI     | 018aa40d3109ca3f48e530ace4f9c2c85d23acbb6abf2a57ebaec4dc9f24a264 |
| PAMJA      | 9856afdbb68fde3da4eec5d02f2db99412f58a4275c3d91db28b8fa01a73a50c |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 0abb88cf3f2c84f1865333f3876157df5c571554c2b9d23dcb00cd1916d8b016                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | af2eff8ceb96ddd2f94c87aa44001511ffb7ade52559e069c66da2a10eed6fb8                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0abb88cf3f2c84f1865333f3876157df5c571554c2b9d23dcb00cd1916d8b016>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




# Le Pen nis fushatën për 2027, por tensionet me Bardellan tronditin të djathtën ekstreme franceze

AKTUALITET BOTA E DIEL, 13 SHTATOR 2026 20:01



Marine Le Pen ka rikthyer zyrtarisht fushatën për zgjedhjet presidenciale të vitit 2027, duke mbajtur fjalimin e parë të madh në bastionin e saj politik Hénin-Beaumont, në një kohë kur partia e saj përballlet me tensione të brendshme, polemika për Ukrainën dhe një seri skandalesh.

Kandidatja e Tubimit Kombëtar (RN) për zgjedhjet presidenciale të vitit 2027 u rikthye të dielën në Hénin-Beaumont, në veri të Francës, një ditë pasi deputetët e partisë u mbledhën në Le Touquet.



Le Pen vazhdon të kryesojë sondazhet. Sipas një sondazhi të OpinionWay për Les Échos, të zhvilluar më 8 dhe 9 shtator, ajo do të merret 34% të votave në raundin e parë, pavarësisht skenarit elektoral.

Por avantazhi në sondazhe po shoqërohet me probleme të reja brenda RN-së, transmeton Telegrafi.

Në javët e fundit janë shtuar zërat për tensione mes Le Pen dhe Jordan Bardellas, presidentit të RN-së dhe një prej figurave kryesore të partisë.

Sipas Libération, Bardella dyshohet se ka deklaruar më 31 gusht: "Ose ajo, ose unë".

Nërkohë, Le Pen raportohet se po synon t'i japë një rol më të madh në fushatën presidenciale mbesës së saj, Marion Maréchal. Ajo e nisi këtë afrim me një fjalim në mbledhjen parlamentare të RN-së në Le Touquet.

Maréchal kishte mbështetur Éric Zemmourin, liderin e partisë rivale të ekstremit të djathtë Reconquête, gjatë fushatës presidenciale të vitit 2022, në vend të tezës së saj.

Bardella i ka mohuar tensionet, duke deklaruar për BFM-TV: "Gjithçka po shkon shumë, shumë mirë. Ju siguroj. Unë e mbështes atë 2,000%".

## LAJMET KRYESORE



Shkëlqim Hajdari nga Bronksi: Drejtësi për çlirimtarët e Kosovës!



Kosova bëhet me Qeveri të re, Kurti zgjidhet kryeministër për herë të katërt



Opinion nga Elvin BLAKAJ: "Jam mysliman" të Ben BLUSHIT e kam lexuar katër herë



Radio "Europa e Lirë": Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë



I rikthehet sërish pagave të gjyqtarëve, Rama: Marrin 280% më shumë se administrata, gati 2 mijë euro mbi pagën e Presidentit

## TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

## MË TË LEXUARAT

Ai e përshkroi marrëdhënien me Le Pen si një "afërsi politike dhe personale të pathyeshme", duke mohuar gjithashtu se dëshiron t'i imponojë linjën e tij partisë.

Përplasjet mes dy figurave lidhen kryesisht me politikat ekonomike, veçanërisht me reformën e pensioneve.

Bardella e konsideron sistemin aktual francez të pensioneve "ekonomikisht të paqëndrueshëm", ndërsa Le Pen ka mbajtur tradicionalisht qëndrime më mbrojtëse ndaj sistemit ekzistues.

Dallime ka edhe për mënyrën se si duhet trajtuar çështja e ndalimit të mbulesës së kokës në hapësirat publike.

Bardella ka qenë i kujdesshëm që kjo çështje të mos shndërrohet në boshtin kryesor të fushatës, duke deklaruar më 31 gusht se synimi nuk është "të imponohet një kod veshjeje" dhe se për këtë çështje do të zhvillohej një referendum.

Ndërkohë, Le Pen tradicionalisht ka mbështetur më shumë masa proteksioniste, ndërsa Bardella shihet si më pro-tregut.

Një tjetër pikë tensioni brenda RN-së është politika ndaj Ukrainës.

Louis Aliot, nënkryetar i partisë dhe kryetar i bashkisë së Perpignan, deklaroi më 4 shtator se Franca duhet të ndalojë financimin e mëtejshëm të armëve për Ukrainën.

"E mbyllim rubinetin. Sistemi shëndetësor, arsimi, e gjithë ekonomia, gjithçka është shkurtuar deri në kockë, dhe megjithatë ende gjejmë para për të financuar më shumë armë (...) Duhet të dimë gjithashtu se si ta ndalim një luftë", tha Aliot.

Deklarata u shfrytëzua menjëherë nga Édouard Philippe, kandidati i partisë së qendrës së djathtë Horizons për vitin 2027.

Ai akuzoi RN-në për "mbështetje ndaj regjimit të Putinit", duke argumentuar se ndalimi i mbështetjes për Ukrainën do të ishte në interes të Rusisë.

"Dobësimi i Ukrainës, siç dëshiron Marine Le Pen, do të thotë të rrezikosh sigurinë e Evropës dhe Francës. Unë do të bëj gjithçka për ta ndaluar atë", deklaroi Philippe.

Le Pen iu përgjigj duke i kujtuar ish-kryeministrit se ai ishte në detyrë kur Vladimir Putin u prit me ceremoni në Pallatin e Versajës dhe më pas në Fort de Brégançon. Ajo përmendi gjithashtu prijet që Philippe i kishte bërë Dmitry Medvedevit, atëherë kryeministër rus, në Le Havre në vitin 2019.

RN është përballur gjithashtu me një tjetër polemikë pas publikimit të një videoje nga Midi Libre.

Pamjet, të regjistruara në nëntor 2025 në Carcassonne, tregojnë disa policë bashkiakë duke bërë komente raciste, seksiste dhe të lidhura me teori konspirative gjatë një patrullimi natën.

Udhëheqësi i patrullës, i cili ishte përgjegjës për rreth 90% të komenteve, është ish-parashutist dhe kishte qenë vullnetar në shërbimin e sigurisë së brendshme të RN-së.

Ai kishte shoqëruar Bardellan në disa udhëtime, përfshirë turneun promovues të librit të tij dhe nisjen e fushatës së RN-së për zgjedhjet lokale.

Polici u përjashtua nga RN-ja, ndërsa Bardella i cilësoi deklaratat e tij si "të neveritshme".

Prokuroria e Carcassonne njoftoi gjithashtu pezullimin e katër policëve bashkiakë të shfaqur në video.

Kështu, ndërsa Le Pen hyn në fazën e re të garës presidenciale me një epërsi të dukshme në sondazhe, ajo duhet të menaxhojë njëkohësisht tensionet e raportuara me Bardellan, dallimet për politikat ekonomike dhe Ukrainën, si dhe polemikat që rrezikojnë të dëmtojnë imazhin e RN-së para zgjedhjeve të vitit 2027. /Telegrafi/

## MË SHUMË NGA AKTUALITETI



**"Woman Unknown" me regji të kineastes daneze May el-Toukhy, fiton Lua...**



**Kurti fton PDK-në ta propozojë nënkryetarin: Të mos humbim kohë me pr...**



**Droni rus godet trenin në kufirin ukrainas-polak! Shpëtojnë mrekullis...**





Obama ngre alarmin për inteligjencën artificiale: “Nëse nuk e vëmë në...



Kosova bëhet me Qeveri të re, Kurti zgjidhet kryeministër për herë të...



Trump: “Irani dëshiron marrëveshje”, lufta mund të përfundojë pas zgj...

## LAJMET E FUNDIT



Në protestën e 106-të kundër qeverisë, qytetarët përcjellin mesazhet e tyre edhe përmes pankartave

[5 MINUTA MË PARË](#)



“Woman Unknown” me regji të kineastes daneze May el-Toukhy, fiton Luanin e Artë në Festivalin e Venecias

[16 MINUTA MË PARË](#)



Bayerni fiton me vuajtje ndaj Elversberg, Kane rigjen golin

[19 MINUTA MË PARË](#)

City shumë i fortë për United, fiton me 10 lojtarë derbin e Manchesterit

[29 MINUTA MË PARË](#)

Shkëlqim Hajdari nga Bronksi: Drejtësi për çlirimtarët e Kosovës!

[33 MINUTA MË PARË](#)

Shpallen fituesit e Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar, Edicioni i 14-të

[55 MINUTA MË PARË](#)

[MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >](#)

Gazeta “KOHA JONË” themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991  
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga “Samë Frasheri”, Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.